LIGJ
Nr. 17/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS, SI SHTESË E KONVENTËS EVROPIANE PËR EKSTRADIMIN, TË VITIT 1957

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 17, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVEND
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të vitit 1957, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.2.2022.

Shpallur me dekretin nr.13494, datë 25.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS,
SI SHTESË E KONVENTËS
EVROPIANE PËR EKSTRADIMIN,
TË VITIT 1957

Mbretëria e Spanjës dhe Republika e Shqipërisë, në vijim të referuara si "Palët";

me dëshirën për të ruajtur dhe forcuar lidhjet e tyre ligjore dhe gjyqësore;

me dëshirën për të përmirësuar procedurat e ekstradimit, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e vendit, lidhur me dorëzimin e ndërsjellë të autorëve të veprave penale;

me dëshirën për të plotësuar dispozitat e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 (Konventa Evropiane për Ekstradimin) dhe për të lehtësuar zbatimin e saj ndërmjet Palëve, veçanërisht në lidhje me ekstradimin e shtetasve të tyre përkatës;

ndërsa, në lidhje me ekstradimin e shtetasve, qeveria e Republikës së Shqipërisë, kur ka depozituar instrumentin e saj të ratifikimit të Konventës Evropiane për Ekstradimin, ka deklaruar, duke iu referuar dispozitës së parashikuar nga neni 6 (1) i Konventës në fjalë, se: "Republika e Shqipërisë refuzon ekstradimin e shtetasve të saj, me përjashtim të rasteve kur është e parashikuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare ku Shqipëria është palë",

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Ekstradimi i shtetasve

Palët bien dakord të ekstradojnë reciprokisht shtetasit e tyre, me qëllim ndjekjen penale për kryerjen e veprave penale, për ekzekutimin e një dënimi ose zbatimi të një mase sigurimi, në përputhje me dispozitat e Konventës Evropiane për Ekstradimin.

Palët bien dakord se shtetësia nuk do të jetë pengesë për ekstradimin e shtetasve të tyre.

Neni 2
Kanalet e komunikimit

1. Palët caktojnë Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Drejtësisë të Mbretërisë së Spanjës si Autoritete Qendrore kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet Qendrore komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, duke u përpjekur që të përdorin teknologji të reja, me qëllim zgjidhjen e ndonjë çështjeje që mund të dalë gjatë përpunimit të kërkesave të ekstradimit.

3. Pavarësisht nga sa më sipër, Palët mund të përdorin kanale diplomatike për dërgimin ose marrjen e kërkesave të ekstradimit, ose informacion në lidhje me zbatimin e tyre, kur e çmojnë të nevojshme për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes.

Neni 3
Zbatimi i përkohshëm

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për vepra penale të kryera para ose pas datës së hyrjes në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për kërkesat e ekstradimit të marra para datës së hyrjes në fuqi.

3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, kërkesat e ekstradimit të marra para datës kur Marrëveshja nuk është më në fuqi do të vazhdojnë të rregullohen nga kjo Marrëveshje pavarësisht përfundimit të saj.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje lidhet për një afat kohor të pacaktuar dhe hyn në fuqi në datën e njoftimit të fundit mbi përfundimin e procedurave të brendshme nga Palët.

Neni 5
Vlefshmëria dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga secila Palë, në çdo kohë, duke njoftuar përmes kanaleve diplomatike. Ky përfundim hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së njoftimit përmes kanaleve diplomatike.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, përfaqësuesit e autorizuar, sipas rregullave nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në dy kopje, në Madrid, në datën 4 tetor 2021, në gjuhën shqipe, spanjolle dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR MBRETËRINË E SPANJËS

Edi Rama
Kryeministër

Pedro Sánchez Pérez-Castejón
Kryeministër